



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E INSPEKSIONIT

### N J O F T I M


Njoftohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari hoteliere (kafiteri, bare, restorante, disko-klube, etj.) në zonat e banimit se **u ndalohet** që të emetojnë zhurmë, e cila i tejkalon kufijtë e përcaktuar me ligj. Gjithashtu, kërkohet nga pronarët e këtyre lokaleve të respektojnë orarin e punës, ashtu siç është i paraparë me ligj.

Bazuar në legjislacionin në fuqi ndalohet kryerja e veprimtarive të cekura më lart, nëse paraprakisht nuk është bërë izolimi akustik i lokalit, në mënyrë që zhurma që emetohet nga muzika të mos shkaktojë bezdi te banorët përreth subjektit afarist.

Në rast të mosveprimit sipas këtij njoftimi, Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do të ndërmer masa përkatëse ligjore, mbylljen e lokalit afarist dhe inicimin e procedurave gjyqësore.

Mbetemi të përkushtuar që të mbrojmë dhe të stimulojmë zhvillimin e të gjitha bizneseve në komunën tonë, por mbi të gjitha jemi të interesuar që të mbrojmë interesin publik të qytetarëve tanë.

Nr.11-334/07-0044802/18  
Podujevë, 05.06. 2018



DREJTORI  
Durim Salihu